



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2024

Lënda: Kthim përgjigje

E nderuar

Në vijim të shkresës Tuaj datë 16.01.2024, të administruar në Bashkinë Shkodër me nr. prot 909, datë 16.01.2024 Ju informojmë se Bashkia Shkodër ka patur në vëmendje të saj sigurimin e pjesmarrjes të shoqërisë civile në dëgjesat publike për të garantuar përcjelljen e zërit të qytetarëve në proceset vendimarrëse më poshtë gjeni përgjigjen për secilen pyetje të parashtruar nga ana juaj.

1. Për vitin 2023 janë organizuar 12 takime gjatë periudhës së përgatitjes së buxhetit. Konsultimet publike janë realizuar me anë të takimeve në Njesitë Administrative dhe në Lagje, sipas kalendarit të publikuar në faqen ëeb. Informacioni është i aksesueshëm në faqen ëeb të Bashkisë Shkodër, në rubrikën Këshillim me Publikun në linkun <https://bashkiashkoder.gov.al/keshillim-me-publikun/>

Në të gjitha dëgjesat publike kanë qënë të ftuar organizata të shoqërisë civile për të diskutuar mbi objektivat dhe prioritetet. E njëjta procedurë ndjeket edhe në rastin e hartimit të dokumentave strategjike, planeve vendore dhe thirrjeve për projekt propozime dedikuar organizatave të shoqërisë civile.

Sa i perket degjesa publike te zhvilluara nga Keshilli Bashkiak per vitin 2023, ne kuader te detyrimeve te parashikuara ne nenin 18 te ligjit nr.139/2015 keshilli bashkiak ka konsultuar me publikun 5 projekt- vendime

1. Projekt- vendim per rregulloren e kundravajtjeve administrative
2. Projekt- vendim per rregulloren e mbetjeve
3. Projekt- vendim per planin e mbareshtimit te pyjeve, ekonomia pyjore proemosheldi
4. Projekt- vendim per disa shtesa dhe ndryshime ne taksat dhe tarifate vendore

5. Projekt- vendim per miratimin e buxhetit 2024 dhe PBA 2024-2026 Bashkia Shkoder

I gjithë informacioni është lehtësisht i aksesueshëm në faqen web të Bashkisë Shkodër, në linkun: <https://bashkiashkoder.gov.al/keshillim-me-publikun/>

Ndërsa dëgjesa publike të dedikuara vetëm për shoqërinë civile për vitin 2023 janë 2 të tilla, njëra për përmirësimin e shërbimeve sociale në bashkinë Shkodër dhe tjetra për shoqatat sportive.

2. Format e ndjekura për organizimin e degjesave publike janë në respektim të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftim dhe Konsultim Publik”. Konkretisht janë ndjekur të gjithë hapat ligjor sipas ligjit për Konsultimin me Publikun. Në çdo rast në faqen eeb të Bashkisë Shkodër publikohet:
 - ✓ Njoftimi i Konsultimit Publik
 - ✓ Kalendari i Konsultimit Publik
 - ✓ Procesverbali i Takimit Publik
3. Numri i pjesmarrjes së organizatave të shoqërisë civile në degjesat publike për përparatjen e buxhetit vjetor 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm 2023 – 2025 nuk është i detajuar, ndërsa numri i pjesmarrjes së organizatave të shoqërisë civile në dy dëgjesa të dedikuara për to është si më poshtë vijon:
 - ✓ Në takimin me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve sociale në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër kanë marrë pjesë 30 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile
 - ✓ Në takimin e organizuar në kuadër të shpalljes së thirrjes publike dedikuar shoqatave sportive sipas Metodologjinë LOD, të Programit Reload kanë marrë pjesë 15 përfaqësues të shoqatave sportive.
4. Të dhënat e koordinatorit për njoftim dhe këshillim i gjeni të publikuara në linkun: <https://bashkiashkoder.gov.al/pjesemarrja-qytetare-ne-vendimmarrje/>
5. Në lidhje me koodinatorin për shoqërinë civile, Bashkia Shkodër në varësi të fushës së veprimit të shoqatës, nëpërmjet drejtorive respektive koordinon punën për mbarëvajtjen e aktiviteteve. Secila drejtori është përgjegjëse për bashkëpunimin me shoqatat respektive, prandaj edhe stafet e tyre janë trajnuar në këtë fushë.
6. Këshilli Vendor i Rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë Kryetarit të Bashkisë. Këshilli Vendor i rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme:
 - a) këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë;

- b) vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor;
- c) propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë;
- d) bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë.

Gjithashtu në kuadër të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile përmes metodologjisë LOD të Programit ReLOaD, për thirrjen e hapur dedikuar shoqatave sportive ngrihet një komision vleresimi i cili shqyrton projekt propozimet. Organizatat e shoqërisë civile përfaqësohen në komisionin e vlerësimit nga një anëtar i OSHC-së me të drejta të barabarta me anëtarët e tjerë. Përzgjedhja e këtij anëtari bëhet me shpalljen e një thirrje të hapur për përfaqësuesit e të gjitha organizatave të shoqërisë civile. Njoftimi i Thirrjes Publike publikohet në faqen web <https://www.bashkiashkoder.gov.al> si dhe në median sociale të Bashkisë Shkodër.

Gjithashtu për këtë shpallje kontaktohen me email organizatat e shoqërisë civile që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Bashkisë Shkodër nëpërmjet postës elektronike. Njëkohësisht, Bashkia Shkodër publikon për çdo rast njoftimin në faqen zyrtare të saj www.bashkiashkoder.gov.al.

7. VKM 540, datë 21/12/1992, "Për krijimin e Këshillave të Kulturës dhe shpërblimin e tyre" të ndryshuar me VKM 121, datë 25.02.2005, si dhe të Udhëzimit Nr 1, datë 24/05/2005 të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko –kulturore", VKB nr.27 datë 01.06.2016 "Për ngritjen e Këshillit artistiko-kulturor, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive dhe rinore në Bashkinë Shkodër", i ndryshuar, VKB nr.40 datë 26.10.2023 "Për një ndryshim në VKB nr.27 datë 01.06.2016 Për ngritjen e Këshillit artistiko-kulturor, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive dhe rinore në Bashkinë Shkodër", është ngritur dhe funksionon Këshilli Artistiko-Kulturor i Bashkisë Shkodër.

Me vendim të Këshillit Bashkiak është ngritur Këshilli Artistik Kulturor, i përbërë nga 7 anëtarë. Përfaqësues të këtij Këshilli janë figura të shquara të artit, kulturës, sportit dhe organizatave të shoqërisë civile.

8. Takimin me grupin e punës për Këshillin Vendor Rinor është janë zhvilluar gjatë vitit 2022.

Në vitin 2022 janë zhvilluar konsultime me shoqërinë civile, në këtë proces kanë marr pjesë OJF-të që puna e tyre lidhet direkt me fushën e rinisë. Disa nga këto organizata janë: Save the children, World Vision, Qendra Rinore Arka, Young Enterpreneurs Abania.

9. Stafi i bashkisë Shkodër nuk është trajnuar për veprimtarinë dhe funksionimin e OJF-ve, por është i trajnuar si në kuadër të ofrimit të shërbimeve sociale në komunitet ashtu edhe të shpalljeve të thirrjeve projekt propozime dedikuara organizatave të shoqërisë civile. I tillë është rasti i zbatimit të metodologjisë LOD të programit Reload, i cili zbatohet në bashkinë Shkodër që në vitin 2018, duke u vlerësuar nga UNDP në rang kombëtar me dy cmime të para për bashkëpunimin e bashkisë Shkodër me organizatat e shoqërisë civile.

Vetëm nga ky program, përtë gjithë ciklin e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile që fillon nga momenti i përgatitjes së thirrjes dhe përfundon me monitorimin e projekteve të zbatuara janë trajnuar rreth 25 nëpunës. Trajnimet janë ofruar nga UNDP.

10. Bashkia Shkodër ka parashikuar lehtësira fiskale me VKB nr.1, datë 22.1.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër, i ndryshuar, në të cilën specifikohen rastet e përjashtimit nga detyrimet tarifore për OSHC-të. Përsa i përket licënsimit të OSHC-ve, ju informojmë se ky nuk është një funksion i pushtetit vendor.

Me respekt,

KRYETAR

Benet Beci